



PROPOZIM PER TAKSIMIN E AMBALAZHEVE

Duke konsideruar se akciza e re, e propozuar nga Ministria e Finances

- Perben per prodhuesit vendas te ambalazheve te **politilenit, plastikes dhe qelqit** perkatesisht nje **shtese** prej **38.4%, 41.6%** dhe **30%** ndaj **cmimit te shitjes**.
- Afekton biznese qe kane realizuar **investime**, te cilat mesatarisht jane rrotull **1 milion €** secili, duke nderhyre ndjeshem negativisht ne planet e shlyerjes se ketyre investimeve
- Do te sillte nje **rritje te ndjeshme te cmimeve**, qe varion nga **0,5%** ne **3%**, bile shume teper per produktet me cmim te ulet, sepse keto ambalazhe jane pjese perberese e tregimit te shumices se mallrave te konsumit te perditshem

Duke gjykuar se akciza e re, e propozuar nga Ministria e Finances

- Do te sillte **uljen e aftesise konkurruese te prodhimit vendas**, sepse diferenca e cmimeve me produktet e huaja perkatese fshihet nga akciza shtese.
- Do te sillte si pasoje **uljen e ofertes vendase** per keto ambalazhe, pra dhe **uljen PPB** si dhe **paksimin e te punesuarve** ne industrine e prodhimit te ketyre ambalazheve
- Le menjane faktin se shume mallra dhe produkte **nuk mund te ambalazhohen ndryshe**, te cilat ne vendet e tjera perjashtohen nga taksimi
- **Nje ligj te vecante** per taksimin e ambalazheve, si ne ato vende qe praktikojne kete lloj takse, e thjeshtezon ne nje zgjerim te tabelës se akcizave ekzistuese
- Eshte ne **sens te kundert me reformen fiskale** te deritanishme te kesaj Qeverie, e cila ne thelb ka qene e orientuar nga reduktimi i taksave per biznesin



Me shpresen qe nje dialog konstruktiv i Qeverise me perfuqesuesit e biznesit

- Mund dhe duhet te zhvillohej ne frymen e “*Small Business Act*”, lancuar nga Komisioni Europian, drejt nje kompromisi ndaj nevojave per likuiditete si te Qeverise ashtu dhe te Biznesit
- Do te ngjallte tek sipermarrja private besimin ne zgjidhjen e problemeve ne rruge institucionale ne vend te asaj individuale, qe shpesh lidhet me shkeljen e ligjit

Me vemendje ndaj afrimit te qendrimeve te Qeverise dhe biznesit direkt te interesuar, propozojme:

a) vendosjen e nje **ekotakse** sipas tabelës së mëposhtme:

Ambalazh plastik (leke/kg)		Ambalazh qelqi (leke/kg)		Ambalazh i perzier (leke/kg)	
Fillestar	I ricikluar	Fillestar	I ricikluar	Fillestar	I ricikluar
5	2,5	2	1	4	2

b) hartimin, ne bashkepunim edhe me sipermarrjen private, te nje strategjie kombetare, te shoqeruar me nje plan konkret veprimesh, rregullash e ligjesh, mbi mbrojtjen e ambientit, ne kuader te nje zhvillimi te qendrueshem

Kryetari

Andrea Xhavera

